



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
SARANDE

Nr. 1851/1 Prot

Sarandë më dt.06.10.2021

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës suaj të dt.06.10.2021.

Drejtuar: Qendra Shqiptare MediaLook
[REDACTED]

Në përgjigje të kërkesës suaj të dt.06.10.2021 të dërguar në adresë emaili: "irishasani@gmail.com,përsa ju kërkoni në kuadër të së drejtës së informimit,ju informojmë sa më poshtë:

Në vijimësi të shkresës sonë nr.1851/1.prot dt.06.10.2021 ,sic ju kemi informuar aktualisht në këtë prokurori po vazhdojnë hetimet paraprake në lidhje me procedimin penal nr.638 të vitit 2017 ,si dhe në këto kushte duke qenë se çështja është ende në hetim, aktet e dosjes hetimore nuk mund të jepen për shkak të sekretit hetimor.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

DREJTUESI I PROKURORISË

Alfred SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
SARANDË

Nr. 185/1 Prot

Sarandë më dt.06.10.2021

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës suaj të dt.18.08.2021.

Drejtuar: Qendra Shqiptare MediaLook
[Redacted]

Në përgjigje të kërkesës suaj të dt.18.08.2021 të dërguar në adresë emaili: "irishasani@gmail.com,përsa ju kërkon në kuadër të së drejtës së informimit,ju informojmë sa më poshtë:

Në bazë të materialit të parë hetimor të dërguar me shkresën nr.12782/48.prot dt.08.09.2017,më dt.11.09.2017 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë është regjistruar procedimi penal nr.638 për veprat penale të "Kontrabanda me mallrat ë tjera"dhe "Fallsifikimi i dokumentave",të parashikuar nga nenet 174/1 dhe 186 të K.Penal,pa autor.

Më dt.01.07.2019 hetimet paraprake në lidhje me këtë procedim penal janë pezulluar për zbulim të autorit.

Gjithashtu mbi bazën e një kallëzimi penal nr.524.akti/70.akti dt.01.03.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë ,në këtë prokurori më dt.19.04.2021 është regjistruar edhe procedimi penal nr.209 për veprat penale të Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore", "Fallsifikimi i dokumentave" dhe "Shpërdorim i detyrës" ,të parashikuara nga nenet 174/1,186 dhe 248 të K.Penal.

Po më dt.19.04.2021 është vendosur rifillimi i hetimit të pezulluar në lidhje me procedimin penal nr.638 të vitit 2017.

Gjithashtu më dt.19.04.2021 është vendosur dhe bashkimi i dy procedimeve penale të sipër përmendura në një procedim penal të të vetëm,si dhe për procedimin penal nr.638 të vitit 2017 hetimet paraprake po vazhdojnë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

DREJTUESI I PROKURORISË
Alfred SHEHU

